

**Kërkesë për pranim paraprak (DAP) në vitin e parë bachelor në një universitet francez,
viti akademik 2025-2026**

I- Plotësimi i kërkesës

- Kërkesa mund të shkarkohet në adresat e mëposhtme:

- **regjistrim në universitet:**

<https://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/sites/default/files/2024-10/dossier-blanc-2025-2026-34737.pdf>

Para se të plotësoni dosjen, lexoni me vëmendje udhëzimet që do të gjeni në:

<https://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/sites/default/files/2024-10/notice-du-dossier-blanc-2025-2026-34734.pdf>

- **regjistrim në shkollën kombëtare të lartë të arkitekturës (ENSA):**

https://www.formulaires.service-public.fr/gf/cerfa_16116_05.do

II- Dorëzimi i dosjes

Kandidatët që regjistrohen për herë të parë në vitin e parë të licencës në një universitet francez do të dërgojë **me email** tre dosjet e plotësuara siç kërkohet nga data 1 tetor deri më 15 dhjetor 2024 në adresën e mëposhtme: kubfrancetirana@gmail.com

Kandidatët që duan të regjistrohen për herë të parë në një ENSA duhet të plotësojnë dosjen dhe ta dorëzojnë atë në formë letre (dosja bashkangjitur) në KubFranceTirana, Instituti Francez i Shqipërisë. Dosjet e aplikimit do të dërgohen me postë nga KubFranceTirana, Instituti Francez i Shqipërisë, njëkohësisht në dy shkollat e larta kombëtare të arkitekturës që kandidatët do të kenë zgjedhur në dosjen e verdhë të DAP.

Në mënyrë që aplikimi juaj për regjistrimin në ciklin e parë në universitetet franceze të merret parasysh, do t'ju duhet të dërgoni një dosje të plotë, e cila nuk duhet të kalojë 6 mega në total. Dërgesa juaj duhet të përfshijë 3 dokumente në versionin PDF. Secila nga 3 dosjet duhet të jetë e plotë. Nëse nuk keni një diplomë DELF ose DALF, duhet të bashkëngjiti certifikatën e regjistrimit të TCF (shih pikën V).

Vërtetimi i marrjes së dosjeve tuaja do t'ju dërgohet me email në adresën tuaj elektronike.

Në mënyrë që Ambasada të japë mendimin e saj për aplikimin tuaj, do t'ju propozohet një intervistë në distancë ose personalisht nga data 15 dhjetor 2024 deri më 30 janar 2025.

KUJDES

- Për DAP ju duhet të plotësoni një dosje për çdo formim të kërkuar, brenda kufirit të tre zgjedhjeve, ndërsa për studime në arkitekturë, një dosje për çdo ENSA (2 zgjedhje).
- Pas datës 15 dhjetor 2024, nuk do të pranohet asnjë dosje.

III - Informacione

KubFranceTirana, Instituti francez i Shqipërisë, që gjendet në Piramidën e Tiranës, është në dispozicionin tuaj.

Merrni takim me mail: kubfrancetirana@gmail.com

IV - Shqyrtimi i kërkesës për regjistrim

KubFranceTirana, Instituti Francez i Shqipërisë e dërgon në të njëjtën kohë dosjen e aplikimit në të tre universitetet e kërkuara; të tre zgjedhjet i nënshtrohen ekzaminimit të njëkohshëm nga të tre universitetet.

Duke pasur parasysh parimin e autonomisë arsimore të universiteteve, vendimi i pranimit u takon ekskluzivisht institucioneve të arsimit të lartë. Asnjë ankesë nuk është e pranueshme.

V-Njohuritë e gjuhës frënge

Për pjesën më të madhe të degëve, niveli i kërkuar i frëngjishtes është niveli B2 i Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (shih shënimin shpjegues). Ju lutemi vini re: disa degë universitare do të kërkojnë që kandidatët të kenë një nivel më të lartë të gjuhës: interesohuni paraprakisht pranë universiteteve.

Kopje e diplomës ose certifikatës DELF B2 (ose DALF C1, C2) bashkëngjitur dosjes, ose mundësia e marrjes së testit të njohurive franceze (TCF për të gjithë).

TCF TP me testin e detyrueshëm të shprehjes me shkrim do të zhvillohet më 16 dhjetor 2024. Tarifa e regjistrimit 74 €. Afati i fundit i regjistrimit 9 dhjetor 2024.

Për informacion mbi TCF dhe regjistrim, duhet të merrni detyrimisht një takim me email me znj. Alda Hoxha campus.france@aftirana.org

Informacion shtesë: <https://www.france-education-international.fr/tcf-dap>

Nxënësit e seksioneve dygjuhëshe frëngjisht-shqip janë të përjashtuar nga testi i gjuhës frënge.

VI- Viza studentore

Vendimi për t'u pranuar në një universitet ju lejon të paraqisni një aplikim për një vizë studentore afatgjatë. Të gjitha informacionet dhe procedurat janë të aksesueshme në adresën e mëposhtme: <https://al.ambafrance.org/Demander-un-visa-pour-la-France-en-Albanie>

Shënim i rëndësishëm: Për marrjen e vizës duhet të keni burimet financiare të nevojshme (rreth 615 € në muaj).